TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. I/18
Dt. 14.3.2017

Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2016

Vendimi: Nr. I/18

Bordi i Drejtorëve i HK "Trainkos" Sh.A njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2016 në mbledhjen Nr. 21 të mbajtur më datë 14.03.2017

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	**Gelor Shala** **Kryeshef Ekzekutiv**	**Sadik Kryeziu** **Kryesuesi i BD**
Nënshkrimi:		
Data:	15.02.2017	14.03.2017

trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS

RAPORT VJETOR 2016



PËRMBAJTJA

I.	**Hyrje**	3
II.	**Raport i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve**	4
II. 1.	Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
II. 2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten	7
II. 3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv	8
II. 4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A	9
III.	**Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv**	10
III. 1.	Ngjarjet kryesore të vitit	12
IV.	Pasqyra e performancës operative	15
IV. 1.	Transporti i Mallrave	15
IV. 2.	Transporti i Udhëtarëve	19
IV. 3.	Sektori i Mirëmbajtjës	22
V. 3.	Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet	23
V. 1.	Gjendja financiare janar – dhjetor 2016	23
	Tabela 1. Të hyrat dhe Shpenzimet Operative për periudhën janar – dhjetor 2016	25
V. 2.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas Bankës (31.12.2016)	27
V. 3.	Bilanci i gjendjes	28
VI.	Projektet kapitale	29
VII.	Perspektiva për vitin e ardhshëm	31
VII. 1.	Rreziqet e të ardhmes së korporatës	32
VIII	**Struktura organizative e Trainkos Sh.A**	33
VIII. 1.	Kontestet gjyqësore në periudhën janar - dhjetor 2016	35
VIII. 2.	Kontestet gjyqësore të pritura në vitin 2017	36
IX.	Transaksionet e realizuara	37
X.	**Përfundim**	38

I.	**Aneks Raporti**	
	Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet	
	Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2016	
	Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve	

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2016, kompania është ballafaquar me një mori problemesh të cilat kanë ardhur si rezultat i mosrealizimit të kënaqshëm në transportin e mallrave si pasojë e problemeve financiare të kompanisë "NewCo Feronikel" e cila ka shkaktuar impakt të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave financiare të HK-Trainkos Sh. A. si dhe mos mbulimi i shpenzimeve të krijuara në transportin e udhëtarëve nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës, të gjitha këto të lartcekura kanë bërë që HK-Trainkos Sh. A. përkundër angazhimeve të larta nga ana e Menaxhmentit të rezultojë me bilanc negativ financiar.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të vitit 2016. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat ndikuese në zhvillimin e biznesit të saj si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim raporti vijohet nga raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar me këtë rast të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të çështjes së perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore e skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2016 i HK-Trainkos Sh. A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, raport vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2016 dhe raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Nga mesi i muajit shtator 2015 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh. A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara, angazhim i cili ka vazhduar edha gjatë gjithë vitit 2016.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve. Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues si dhe drejtorëve të Bordit që kanë vepruar deri në emërimin e Bordit aktual është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2016.

II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2016 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera.

Një ndër sfidat me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte mungesa e mjeteve për të mbuluar shpenzimet në transportin e udhëtarëve, sfidë e cila është duke vazhduar edhe tani. Përderisa mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është definuar qartë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, kjo çështje ende nuk ka marr zgjidhjen e duhur nga institucionet përkatëse. Çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është njëri prej problemeve që e ka përcjell ndërmarrjen qysh nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës dhe si e tillë ende nuk është trajtuar sipas kërkesave ligjore. Mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës për këtë qëllim për çdo vit radhazi kanë ardhur duke u zvogëluar, po ashtu edhe rëniet në transportin e mallrave kohëve të fundit kanë qenë shumë të

theksuara të cilat kanë bërë që ndërmarrja të jetë në një situatë tejet të vështirë. Kjo çështje do të jetë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqet njërin prej shkaqeve më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Kompletimi me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A gjithashtu ka qenë fokus i Bordit dhe menaxhmentit që t'i përmbushim këto obligime.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2016**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2016 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Për shkak të gjendjes në ndërmarrje, mosmbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve dhe për shkak të rënies së transportit të mallrave ndërmarrja ka bërë rishikimin e Planit të Biznesit për vitin 2016.

Përkundër përpjekjeve dhe angazhimit të përbashkët të Bordit dhe të stafit të kompanisë, objektivat e përcaktuara nuk është të arritur të përmbushën gjatë këtij viti në pjesën e transportit të udhëtarëve dhe atë të mallrave për shkaqet të cilat u theksuan më sipër. Besojmë që viti 2017 do të jetë më realizim më të mirë pasi që klienti ynë kryesor NewCo ferronikeli ka filluar transportin dhe kemi arritur marrëveshje për transport. Gjithashtu, besojmë që edhe në rastin e rishikimeve buxhetore, çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve do të marrë zgjidhjen e duhur nga ana e Aksionarit.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve si dhe të transportit.

Bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016. Në këtë drejtim ka pasur disa avancime në ndërtimin e një bashkëpunimi shumë domethënës. Projekti i fituar nga qeveria holandeze për trajnimin e stafit ekzekutiv (makinistë, ndihmës makinistë/udhëheqës treni, frenues manovrues si dhe për stafin e mirëmbajtjes) ka vazhduar edhe në vitin 2016.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2016 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo të kënaqshëm operativ e financiar. Përkundër angazhimit maksimal të menaxhmentit të kompanisë kemi pësuar rënie në transportin e mallrave si rezultat i ndikimit të faktorëve të jashtëm. Po ashtu edhe në këtë vit realizimi financiar në transportin e udhëtarëve ende ka mbetur i paarritshëm për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve nga ana e Qeveris së Republikës së Kosovës ashtu siç është paraparë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për - 69 % neto tonë mallra të transportuara më pak se sa planifikimi, apo për - 67 % më pak se realizimi gjatë vitit 2015.

Performanca financiare nga transporti i mallrave është për - 72 % më pak se sa planifikimi vjetor 2016, ndërsa krahasuar me vitin paraprak është më pak për - 69 %.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për + 3.66 % më shumë në krahasim me vitin paraprak si dhe për – 10.26 % më pak se sa planifikimi për vitin 2016.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të të hyrat nga kjo kategori kanë qenë - 2.38 % krahasuar me planifikimin 2016, ndërsa krahasuar me vitin 2015 të hyrat kanë qenë prej - 0.71 % më pak. Për shkak të mosrespektimit të Ligjit për Hekurudhat shpenzimet e qarkullimit të trenave të udhëtareve ende mbeten të pambuluara.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2016 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Gjatë vitit 2017, presim që të arrihet marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për mbulimin e shpenzimeve në Transportin e Udhëtarëve ashtu siç parashihet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Gjithashtu vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për këtë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim, për këtë qëllim kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik.

Për të përcaktuar nevojat për investime, kompania është e angazhuar në hartimin e një plani afatmesëm për investime.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm presim arritjen e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2017 siç është rritja e transportit të mallrave vendor dhe ndërkombëtarë si dhe rritje në transportin e udhëtarëve.

II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Përkundër ngecjeve dhe vështirësive që ka pasur në realizimin e projekteve në të kaluarën, gjatë vitit 2016 ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për të gjitha projektet kapitale të planifikuara. Projektet janë në fazën finale të realizimit dhe së shpejti do t'i kemi në funksion.

Mjetet për projektet kapitale në shumën prej 850,000.00 € të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2016 janë shfrytëzuar në tërësi. Po ashtu ndërmarrja edhe me buxhetin e saj ka realizuar disa projekte të rëndësishme.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh që do të ndikonte

negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Mirëpo, është më rëndësi të theksohet edhe fakti tjetër se humbjet financiare gjatë vitit 2016 janë të larta për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve nga ana e ministrisë përkatëse dhe për shkak të ndërprerjes së transportit nga ana e klientit kryesor NewCo Ferronikeli.

Për shkak të kësaj gjendje, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit që do të mundësonte shpërndarjen e **dividentës**, (fitimit) ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 06/49,të datës 16.09.2015. Në bazë të këtij vendimi si dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2016 Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A ka mbajtur gjithsej 14 mbledhje. Dymbëdhjetë prej tyre kanë qenë të planifikuara, një e jashtëzakonshme si dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat e vendosura në tabela për strukturën e Bordit të Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2016.

Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë:

PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK TRAINKOS SH.A			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Sadik Kryeziu	Kryesues	14
2	Naim Gashi	Anëtar	13
3	Labinot Halilaj	Anëtar	14
4	Bujar Hasimi	Anëtar	14
5	Bastri Sallahu	Anëtar	14
6	Mustafa Mustafa	Anëtar	13
7	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	14
8	Afrim Kuleta	Sekretar	13

II. 4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK – TRAINKOS Sh. A.

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari.

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim të dhënat për përbërjen e këtyre komiteteve, kohën e funksionimit si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2016.

Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e bordit:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri		Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 09.10.2015 - aktiv	1	Labinot Halilaj	Kryesues	11
	2	Naim Gashi	Anëtar	12
	3	Mustafa Mustafa	Anëtar	11
KOMITETI PËR STAF DHE SHPËRBLIME 30.10.2015 - 30.12.2016	1	Sadik Kryeziu	Kryesues	8
	2	Labinot Halilaj	Anëtar	8
KOMITETI PËR PROJEKTE KAPITALE 30.10.2015 - 30.12.2016	1	Naim Gashi	Kryesues	7
	2	Bastri Sallahu	Anëtar	7
KOMITETI I FINANCAVE 30.10.2015 - 30.12.2016	1	Bujar Hasimi	Kryesues	8
	2	Mustafa Mustafa	Anëtar	8

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A
Sadik Kryeziu – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh. A. arriti që vitin 2016 ta përmbyll me vështirësi të mëdha, kjo si rezultat i faktorëve që tanimë dihen siç janë rënia në transportin e mallrave si dhe mos mbulimi i shpenzimeve në transportin e udhëtarëve nga Ministria e Infrastrukturës.

Përkundër vështirësive të cekura më lart viti 2016, karakterizohet edhe me disa sfida dhe probleme të reja e të vjetra. Ngecjet më të theksuara kanë qenë në realizimin e objektivave nga të hyrat në transportin ndërkombëtar të mallrave si rezultat i krizës ekonomike në eurozonë e posaçërisht në Greqi ku dihet se transportin më të madh e kemi nga porti i Selanikut. Po ashtu, ngecje tjetër ka qenë edhe shkurtimi i të hyrave nga Marrëveshja për Obligimet e Shërbimeve të Publikut – OSHP.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që dhe këto obligime t'i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron, siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurruese të tregut. Në të njëjtën kohë jemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Një prej sukseseve të veçuara gjatë vitit 2016 është realizimi i projekteve kapitale, projekte të cilat së shpejti do t'i kemi në operime. Përkundër realizimit të këtyre projekteve, sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK-Trainkos Sh.A. mbetet padyshim investimi në flotën e mjeteve lëvizëse (lokomotiva, vagonë dhe trena motorikë). Për shkak të gjendjes së mjeteve lëvizëse, vjetërsisë së tyre dhe amortizimit, kërkohen investime emergjente.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2016 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A.

Jemi të përkushtuar që të kemi angazhim maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë. Do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë.

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala

III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Aktivitet më të rëndësishme të cilat na kanë shoqëruar gjatë vitit 2016 janë të paraqitura si në vijim:
Aktiviteti biznesor me partnerët regjional gjatë vitit 2016 kufizohet në vazhdimin e iniciativave për bashkëpunim regjional dhe bilateral me shtetet e regjionit, të kufizuara kryesisht përmes shtetin të Maqedonisë nëse e kemi parasysh lidhjen e vetme ndërkombëtare hekurudhore. Insistimi për finalizimin e procesit të gjatë për nënshkrimin e "Marrëveshjes zbatuese për ndërlidhje të rrjeteve hekurudhore ndërmjet Hekurudhave të Kosovës dhe Hekurudhave Maqedonase" dhe "Dispozitat e përbashkëta zyrtare për rregullimin e komunikacionit kufitar hekurudhor në linjën kufitare Hani i Elezit – Vollkovë" ka rezultuar me sukses. Nënshkrimi i Marrëveshjes është bërë më datën 15.02.2016, në Fushë Kosovë mes kompanive publike hekurudhore të të dy shteteve. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje krijohet baza për të zbatuar Marrëveshjen e Traktatit për Transport, duhet që paraprakisht të bëhet edhe nënshkrimi i Marrëveshjes për kalimin kufitar edhe për dogana, polici dhe fitosanitari. Kjo nuk ka ndodhur brenda vitit 2016 dhe mbetet tek MI-ja të veprojë dhe planifikojë për këtë aktivitet për vitin 2017.

Nënshkrimi i marrëveshjes është mirëpritur nga institucionet e BE-së që përcjellin dhe mbështesin zhvillimet e sektorit hekurudhor në Republikën e Kosovës. Rëndësia e këtyre marrëveshjeve bilaterale është precizuar edhe në konkluzionet e SEETO-s për detyrat që priten të realizohen në Shtetet e Evropës Jug – Lindore.

Kontaktet e rregullta me partnerët regjionalë, kryesisht me ata të Republikës së Maqedonisë janë të përqendruara në krijimin e mundësive për të kaluar nga periudha e rënies drastike e transportit me hekurudhë, kryesisht ai i mallrave nëse e krahasojmë me vitet paraprake. Fillimi i vitit 2016 ka kërkuar kontakte të rregullta për të përcjell krizën e refugjatëve që ka shkaktuar ngecje në transportin hekurudhor ndërkombëtar nëse e kemi parasysh linjën e vetme ndërkombëtare përmes Maqedonisë por edhe problemet tjera të trashëguara që pamundësojnë një koordinim funksional me qëllim të rritjes së vëllimit të transportit të mallrave me hekurudhë që ende vazhdojnë.

Me Hekurudhat Maqedone gjatë vitit 2016 është diskutuar për mundësitë e koordinimit të veprimeve me qëllim të përfitimit të mundësive që ofrohen për transport të mallrave në dhe nga Maqedonia. Mundësia për realizimin e këtyre transporteve krijohet me plotësimin e nevojave për klientin por edhe ofrimi i një çmimi të volitshëm dhe konkurrues për të realizuar transport me hekurudhë edhe në regjionet tjera.

Një aktivitet i rëndësishëm në transportin brenda shtetit është edhe fillimi i transportit për New Co Ferronikeli. Një periudhë dy mujore nën kontratë ka rezultuar me rritjen e optimizmit për të vazhduar së funksionuari kjo kompani – partner i rëndësishëm i Trainkos-it që ka rezultuar me nënshkrimin e kontratës së radhës për gjashtë muajt e parë të vitit 2017.

Bashkëpunimi me Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016, në plotësimin e obligimeve ligjore dhe bashkëpunimin në krijimin e listave të mjeteve lëvizëse që janë në territorin e Kosovës e që nuk janë në pronësi të Hekurudhave. Në fund të vitit

është punuar që të veprohet në iniciativën e krijimit të grupit punues për krijimin e listës së mjeteve lëvizëse të cilat kanë qenë në pronësi të Hekurudhave të Kosovës dhe janë të shpërndara në shtetet e ish-Jugosllavisë (kryesisht në Serbi).

Periudha raportuese për vitin 2016 ka rezultuar me koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në përgatitjen e raportit narrativ për DPSA – Kvartali i katërt 2015 dhe procedurat për takimin e caktuar në takimin e Brukselit (25.02.2016). Sipas kërkesës së Ministrisë për Integrime Evropiane dhe koordinimit me Ministrinë e Infrastrukturës është bërë edhe harmonizimi i Draft agjendës dhe propozimet për vitin 2016 për të cilat janë bërë edhe veprimet e nevojshme sipas kërkesës së entiteteve brenda Qeveris së Kosovës.

Me kërkesën/udhëheqjen e procesit me Ministrinë e Infrastrukturës është bërë plotësimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Associimit (PKZMSA) për periudhën K1, K2, K3 dhe K4.

Po ashtu, edhe në vitin 2016 është arrit marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për Obligimet e Shërbimeve tw Publikut - OSHP, është përsëritë shprehia e viteve të kaluara pas ndarjes së HK-së dhe nuk i mbulon gjithë trenat e aprovuar të udhëtarëve siç e parasheh Ligji për Hekurudhat e Kosovës. I rëndësishëm është edhe neni për kohëzgjatjen e marrëveshjes e cila duhet të jetë për një periudhën prej 3 deri në 15 vite.

Koordinimi për aktivitetet me DPSA me Ministrinë e Infrastrukturës ka rezultuar edhe me avancimin e zbatimit të obligimeve që rrjedhin nga "Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar". Konkretisht do të punohet në zbatimin e Planit të Veprimit 2015-2020. Nëse futet në DPSA mund të fuqizohen mundësitë e mbështetjes me asistencë teknike në: Studimet e fizibilitetit për Terminalet hekurudhore në Kosovë, anëtarësimi në asociacione hekurudhore relevante, përpilimi i Biznes planit pesëvjeçarë për TRAINKOS-in, mbështetja për furnizim me mjete lëvizëse të nevojshme me zhvillimin e sektorit hekurudhor sipas trendeve zhvillimore, një OShP sipas Ligjit, etj.

Më datën 09.06.2016 është plotësuar dhe dërguar aplikacioni për anëtarësim në CER së bashku me INFRAKOS-in. Përgjigja e zyrtarëve nga CER-i është se sipas kushteve, disponimit dhe gjendjes momentale politike kërkesa nuk mund të procedohet në Kuvendin e CER-it sepse ende e kanë reagimin e fuqishëm nga Serbia dhe nuk e kanë mbështetjen e nevojshme nga disa anëtarëve tjerë gjithashtu. Gjatë Konferencës së 15 Shtatorit z. Libor Lochman – Drejtor i CER-it ka përsëritur vullnetin e tij personal në realizimin e kësaj iniciative dhe ka shpjeguar për disa hapa që mund dhe do të bëhen së shpejti në këtë drejtim.
Është vazhduar me kontakte të rregullta për të realizuar objektivat tona me kompetentët zyrtarë të shtetit të Austrisë, Turqisë, Holandës, Anglisë dhe Finlandës.

Sipas planit gjatë viti 2016 janë realizuar trajnimet e Moduleve të planifikuara dhe kanë përfunduar me sukses. Me përfundimin e fazës së trajnimeve kompania zbatuese IES ka përgatitur, realizuar dhe prezantuar Raportin para Menaxhmentit dhe BD-së, me datën 14.06.2016. Raporti është prezantuar në këtë përbërje:

- Sfidat dhe Qasja;

- Gjetjet;
- Sukseset kryesore dhe
- Rekomandimet.

Projekti vazhdon me realizimin e idesë së mbajtjes së një Konference për zhvillimin e sektorit hekurudhor në shtetet e Ballkanit Perëndimorë më datën 15.09.2016, zyrtarisht projekti ka përfunduar më 01.10.2016.

Mbështetja e Qeverisë së Mbretërisë Holandeze me Projektin e trajnimit të stafit ekzekutiv të TRAINKOS-it ka kulmuar me krijimin e mundësive për organizimin e Konferencës për Zhvillimin e Sistemit Hekurudhorë në EJL të mbajtur më 15 Shtator 2016. Kjo Konferencë është aprovuar dhe mbështetur nga të gjithë akterët relevant duke i pas parasysh proceset e ndryshimeve rrënjësore të sektorit hekurudhorë në Republikën e Kosovës, mbështetjen nga BE-ja dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN) si dhe kohën e përshtatshme për t'u mbajtur Konferenca e parë për hekurudhat.

Konferenca e organizuar nga TRAINKOS-i ku mikpritës ka qenë Ministria e Infrastrukturës e cila krijon dhe zbaton politikat zhvillimore të këtij sektori ka mbledhur institucione vendore dhe ndërkombëtare që direkt dhe indirekt ndikojnë në zhvillimin e transportit hekurudhor brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht në Konferencë kanë marrë pjesë aktive institucionet shtetërore dhe publike të Republikës së Kosovës siç janë: MI, MzhE, MF, ARH, INFRAKOS-i dhe TRAINKOS-i, IFN (BERZh-i, BIE dhe Banka Botërore), Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE), SEETO, asociacioni hekurudhorë Evropian – CER dhe përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë të biznesit.

Konferenca është organizuar dhe mbajtur në tri sesione:

1. Zhvillimi i sektorit hekurudhorë në EJL, infrastruktura dhe shërbimet e qeverisë, institucionet financiare, entitetet hekurudhore dhe kompanitë ndërkombëtare;
2. Zbatimi i investimeve nga institucionet ndërkombëtare dhe
3. Diskutimi në tri tryeza të rrumbullakëta për: a) partneriteti publiko-privat, procedurat e prokurimit dhe mundësitë për investime nga kompanitë e huaja; b) mirëmbajtja e infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse në perspektivën regjionale dhe c) zhvillimi profesional i sektorit hekurudhorë regjional.

Nga diskutimet në Konferencë dhe konkluzionet e dala nga kjo Konferencë priten rezultate konkrete që kanë të bëjnë me zbatimin e planit të veprimit (2015 – 2020) të precizuara në "Strategjinë Sektoriale dhe Transportin Multi Modal të Qeverisë së Kosovës dhe "Masat e Buta" për periudhën 2016-2020 të precizuara në dokumentin e lëshuar nga SEETO.

Veprimet për të korrur suksese me këtë iniciativë kërkojnë mobilizim dhe përkushtim më të madh të të gjithë akterëve relevant se deri më tani! Mbështetja në këto procese është garantuar nga ZNKE-ja përmes WBIF-it, IPA-s dhe TAIEX-it.

IV. PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH. A.

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën operative gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, duke prezantuar realizimin operativ krahasuar me planifikimin për të njëjtën periudhë dhe me realizimin e vitit paraprak. Po ashtu do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

IV. 1. TRANSPORTI I MALLRAVE

Sektori i transportit të mallrave është njëri prej sektorëve që ka rolin kryesor për ndërmarrjen. Rezultatet e arritura nga ky sektor në vitin 2016 janë prezantuar në vijim, ku sasia e mallrave të transportuara është shprehur në tonë:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – dhjetor 2016
Realizimi Neto Ton në 2015	742,439.40 Ton
Realizimi Neto Ton në 2016	244,648.61 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2016	798,427.00 Ton
Dallimi: Realizim 2016 – Realizim 2015	- 497,790.79 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2016	- 553,778.39 Ton
Dallimi: Realizim 2016 – Realizim 2015 (%)	- 67 %
Dallimi: Realizim 2016 – Planifikim 2016 (%)	- 69 %

Tabela 1.1

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2016 ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontonjerave	Janar – dhjetor 2016
Kontenjerë të plotë - 2015	729 copë
Kontenjerë të zbrazët - 2015	6 copë
Kontenjerë të plotë - 2016	218 copë
Kontenjerë të zbrazët - 2016	2 copë

Tabela 1.2

Siç mund të shihet nga tabela 1.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 67 % më pak se sa në të njëjtin periudhë raportuese të vitit të kaluar, si dhe rreth 69 % më pak se planifikimi për vitin 2016, vlen te theksohet edhe numri i kontenjerave te cilët janë paraqitur në tabelën 1.2 është dukshëm me i ultë krahasuar me vitin e kaluar.




Figura 1.1

Siç mund të shihet nga figura 1.1, në aspektin operativ kemi një rënie të konsiderueshme nga planifikimi, e cila ka qenë për ketë periudhë raportuese duke pasur parasysh edhe numrin e kontejnerëve të transportuar gjatë vitit që po e lëmë pas.

Përshkrimi	Të hyrat në periudhën vjetore 2016
Realizim shitje të hyra 2015	1,872,057.96 €
Realizim shitje të hyra 2016	582,880.86 €
Planifikimi 2016	2,052,764.20 €
Dallimi realizim 2016 - realizim 2015	- 1,289,177.10 €
Dallimi realizim – planifikim 2016	- 1,469,883.34 €
Dallimi realizim 2016 - realizim 2015 në %	- 69 %
Dallimi Realizim – Planifikim 2016	- 72 %

Tabela 1.3




Figura 1.2

Ndërsa, nga reflektimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart, të hyrat janë për rreth **69** % më pak se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë kohore të raportuese dhe **72** % më pak se sa ka qenë planifikim për periudhën janar - dhjetor 2016.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET NGA TRANSPORTI I MALLRAVE

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet gjatë 2016
Shitjet nga transporti i mallrave	582,880.86
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	63,121.51
Total shitjet	**646,002.37**
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	764,572.18
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	188,895.51
Total shpenzimet	**953,467.69**
Fitimi/humbja	**- 307,465.32**
Marzha në %	**- 32 %**

Tabela 1.4




Figura 1.3

Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të mallrave hyjnë**:**

- ✓ Të ardhurat nga transportimi i kontejnerëve me vlerë: **17,460.00 €**
- ✓ Të ardhurat nga RIV dhe vendosja me vlerë: **38,402.80 €**
- ✓ Të ardhura tjera nga shërbime kompensimi i demit nga aksidentet: **589.00 €**
- ✓ Të ardhura tjera nga riparimi i vagonëve me vlerë: **6,669.71 €**

- Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me një humbje operativ prej - 32 **%** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave përgjatë vitit 2016, duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth 14 % nga totali i tren - kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që ka qenë për vitin 2016.

IV. 2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate jo shumë të kënaqshme.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën janar - dhjetor 2016 me periudhën e njëjtë të vitit 2015. Në këtë tabelë shihet se kemi rënie të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar por edhe me planifikimin e vitit 2016.

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i Udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2015	**268,372**
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2016	**278,190**
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2016	**310,000**
Dallimi: 2016 - 2015	**9,818**
Dallimi: realizim - planifikimi 2016	**- 31,810**
Dallimi: 2016 – 2015	**+ 3.66 %**
Dallimi: realizim - planifikimi 2016	**- 10.26 %**

Tabela 2.1

Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të madh të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo 3.66 % më shumë dhe 10.26 % më pak kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara nga pagesat.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2015	**204,668.67 €**
Realizim shitje të hyra 2016	**203,216.27 €**
Planifikimi 2016	**208,166.00 €**
Dallimi: realizim 2016 - realizim 2015	**1,452.40 €**
Dallimi: realizim - planifikim 2016	**4,949.73 €**
Dallimi: realizim 2016 - realizim 2015	**- 0.71 %**
Dallimi: realizim - planifikim 2016	**- 2.38 %**

Tabela 2.2

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 0.71 % më pak sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth 2.38 % më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 2.1

TË HYRAT DHE SHPENZIMET NGA TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Përshkrimi - Të hyrat	Janar – Dhjetor
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	759,766.98
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	500,000.00
Shitjet nga transporti i udhëtarëve	188,906.83
Të ardhura tjera nga transporti i udhëtareve	14,309.44
Total të hyrat	**1,462,983.25**
Shpenzimet direkte në TU	1,238,085.55
Shpenzimet indirekte në TU	1,160,358.11
Total shpenzimet	**2,398,443.66**
Fitimi / humbja operative	**- 935,460.41**

Tabela 3.3




Figura 2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej **-935,460.41 €** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të udhëtareve hyjnë**:**

- ✓ Të hyrat nga shërbimi i ID kartelave: 1,339.95 €
- ✓ Të hyrat nga shërbime të tjera: 7,731.75 €
- ✓ Të hyrat nga transporti i organizuar për udhëtarë 4,648.74 €
- ✓ Kompensimi nga Aksidentet: 589.00 €

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë një vjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 86.00 % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që ka qenë për vitin 2016.

IV. 3. SEKTORI I MIRËMBAJTJES

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën nga sektori i mirëmbajtjes së trenave motorikë, lokomotivave, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve si dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit janar - dhjetor 2016.

Në vijim është pasqyruar produktiviteti në shfrytëzimin e fuqisë punëtore sesa dhe ku janë shfrytëzuar këto kapacitete si dhe pasqyrohet raporti në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

Shërbimi i mirëmbajtjes së lokomotivave gjatë periudhës janar – dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **19,665.00** orë ku:

- **8,811.00** orë pune, janë shfrytëzuar për riparim apo **44.81 %** e fondit total të orëve;
- **2,797.00** orë pune, janë shfrytëzua për punë ndihmëse dhe dytësore apo **14.22 %** e fondit total të orëve;
- Produktiviteti i tërë ka qenë **11,608.00** ore pune apo **59.03 %.**

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar – dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **14,122.50** orë ku:

- **4,240.00** orë, janë shfrytëzuar për riparim apo **30.02** % e fondit total të orëve
- **2,371.00** orë, janë shfrytëzuar për punë ndihmese dhe dytësore apo **16.79 %** e fondit total të orëve
- Produktiviteti i tërë ka qenë 6,611.00 orë pune apo **46.81%**

LOK. TU LOK. TM T.M. Lok. Mano.	2640 - 001	2640 - 003	2640 - 004	2620 - 005	2640 - 006	2640 - 007	2640 - 008	2710 - 009	2640 - 010	2640 - 016	2760 - 001	2760 - 002	5800 - 001	5800 - 002	5800 - 003	5800 - 004
Servisime	-	51	-	131	-	65	-	4	23	77	13	2	301	178	-	105
Riparime	-	13	-	5	-	3	-	2	6	8	10	4	28	24	-	8
K - 1	-	8	-	7	-	7	-	-	8	4	8	-	7	5	-	2
K - 3	-	2	-	1	-	2	-	-	1	1	2	-	3	1	-	-
K - 6	-	2	-	2	-	2	-	-	2	1	2	-	1	1	-	1

V. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

1. Gjendja financiare janar – dhjetor 2016
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2016)

V. 1. Gjendja financiare janar - dhjetor 2016

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2016, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 582,880.86 € për periudhën janar - dhjetor 2016. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2016, është 897,315.51 € dhe nga kjo del se kemi realizuar 64.96% nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit në shumën prej 381,243.26 € dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 6,657.00 €. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "NewCo Ferronikel" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 194,980.44€.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2016, është realizuar në shumën prej 1,450,013.76 €. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 759,766.98 €, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00 €. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 190,246.78 €, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 54.19%, krahasuar me planifikimet e vitit 2016 – 2,675,457.50 €.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2016, kanë arritur shumën prej 55,862.80 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2016, e cila është 50,000.00 € arrin kuotën prej 111.72%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për ta – 17,460.00 € dhe të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 38,402.80 €.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2016, kanë arritur shumën prej 75,508.60 €. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siq vijojnë: Të hyrat nga riparimi i vagonëve të dëmtuar – 20,228.20 €, të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. –

49,020.65 €, dhe të ardhurat nga zbritjet e marrura 6,259.75 €. Buxheti i planifikuar është 70,000.00 €, shprehur ne përqindjen 107.87%.

Shuma e **Donacionit nga Buxheti i Kosovës** prej 850,000.00 €, për projektet kapitale të parashikuara gjatë këtij viti është transferuar në vlerë prej 800,000.00 €.

Një donacion tjetër ka qenë Granti Holandez që për këtë vit është planifikuar në vlerë prej 35,117.26 €, ndërsa është realizuar në vlerë prej 47,221.00 €, pra përqindja e realizuar është 134.46 %.

Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar – dhjetor 2016, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 1,346,695.23€ nga 1,492,150.00 € të planifikuara për vitin 2016 dhe arrin kuotën prej 90.25%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2016.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,769,155.76 €, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,761,366.15 € dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 7,789.61 €. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2016 – 1,807,500.00 €, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 97.87 %..

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 174,829.94 €, kjo shumë është vetëm 16.22% nga shuma prej 1,077,617.26 € e parashikuar vitin 2016. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2016

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 54.54%, konkretisht në shumën prej 61,230.41 €. Planifikimi per vitin 2016, i kësaj kategorie është 112,250.00 €. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2016

TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2016


	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor2016	Buxheti 2016	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor2015
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	582,880.86	897,315.51	-314,434.65	64.96	1,734,567.09
2	TU – Ministria e Infrastruktures	759,766.98	1,967,292.50	-1,207,525.52	38.62	789,426.50
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	500,000.00	500,000.00	0.00	100.00	500,000.00
4	TU – Shitja e Biletave	190,246.78	208,165.00	-17,918.22	91.39	196,917.12
5	Shërbimet tjera	55,862.80	50,000.00	5,862.80	111.73	102,457.10
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	20,228.20	10,000.00	10,228.20	202.28	42988.31
7	Të hyrat tjera jo operative	49,020.65	60,000.00	-10,979.35	81.70	55,300.17
I	TOTAL – TË HYRAT	2,158,006.27	3,692,773.01	-1,534,766.74	58.44	3,421,656.29
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikuesit	589,558.62	590,000.00	-441.38	99.93	945,544.94
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	43,657.51	51,000.00	-7,342.49	85.60	63,299.78
3	Inventar dhe pajisje	150	5,000.00	-4,850.00	3.00	24.9
4	Material harxhues	0.00	1,050.00	-1,050.00	0.00	4872.74
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	50,626.88	102,000.00	-51,373.12	49.63	46,459.07
6	Qasja në binarë	544,553.99	638,100.00	-93,546.01	85.34	696,220.91
7	Sigurimi i palëve të treta	360.00	9,000.00	-8,640.00	4.00	1,200.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	43,224.45	78,000.00	-34,775.55	55.42	101,574.68
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	65,646.25	3,000.00	62,646.25	2188.21	69,864.02
10	Zbritjet e lejuara	8,917.53	15,000.00	-6,082.47	59.45	74,234.15
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	1,346,695.23	1,492,150.00	-145,454.77	90.25	2,003,295.19
	Fitimi (humbja) bruto	811,311.04	2,200,623.01	-1,389,311.97	36.87	1,418,361.10
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Te Ardhura tjera	0.00	0.00	0.00	0	745,475.46
2	Të ardhurat granti holandez	47,221.00	35,117.26	12,103.74	134.47	29,838.67
3	Te ardhura tjera Grantet		850,000.00	-850,000.00	0	
4	Zbritjet e marra	6,259.75	0.00	6,259.75	0	7,867.36
	TOTAL – Te ardhurat tjera	53,480.75	885,117.26	-831,636.51	6.04	783,181.49
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,761,366.15	1,785,000.00	-23,633.85	98.7	1,741,098.95
2	Sigurimi shendetsor, trajnime dhe Shpenzime tjera	7,789.61	22,500.00	-14,710.39	34.62	32,443.03
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,769,155.76	1,807,500.00	-38,344.24	97.88	1,773,541.98
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve	4,353.63	865,000.00	-860,646.37	0.50	4,210.33
2	Sigurimi fizik – total	40,207.10	50,000.00	-9,792.90	80.41	32,626.26
3	Shërbimet tjera	0.00	0.00	0.00	0.00	245.34
4	Shpenzimet logjistike	19,144.37	22,000.00	-2,855.63	87.02	25,087.60
5	Energjia elektrike dhe shërbimet komunale	0.00	0.00	0.00	0.00	433.18
6	Sigurimi i palëve të treta	2,500.77	7,000.00	-4,499.23	35.73	4,306.53
7	Marketingu	4,141.85	15,500.00	-11,358.15	26.72	2,336.60
8	Udhëtimet zyrtare	13,845.85	38,000.00	-24,154.15	36.44	9,272.34

9	Telefonat dhe Posta	20,890.04	24,500.00	-3,609.96	85.27	26,719.10
10	Shërbimet bankare	1,099.13	1,500.00	-400.87	73.28	1,156.76
11	Tatimet	656.00	4,000.00	-3,344.00	16.40	35,041.68
12	Pajisje elektronike	17,217.01	15,000.00	2,217.01	114.78	10,994.90
14	Shpenzimet e paparishukuar	50,774.19	35,117.26	15,656.93	144.58	29838.67
	TOTAL - Shpenzimet operative	174,829.94	1,077,617.26	-902,787.32	16.22	182,269.29
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	0.00	3,000.00	-3,000.00	0	1,084.53
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	6,656.79	10,200.00	-3,543.21	65.26	12,054.31
3	Material i zyrës	9,688.27	12,000.00	-2,311.73	80.74	12,068.53
4	Material sanitar	3,468.07	5,000.00	-1,531.93	69.36	4,187.28
5	Qiraja për objektet	11,883.03	13,000.00	-1,116.97	91.41	9,206.05
6	Reprezentacioni dhe bufeja	9,700.05	10,000.00	-299.95	97.00	13,190.54
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	13,119.51	15,000.00	-1,880.49	87.46	1,015.16
8	Shpenzimet logjistike	3,898.28	14,050.00	-10,151.72	27.75	7,327.17
9	Kontigjente	2,816.41	30,000.00	-27,183.59	9.39	13,208.75
	TOTAL - shpenzimet administrative	61,230.41	112,250.00	-51,019.59	54.55	73,342.32
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	3,351,911.34	4,489,517.26	-1,137,605.92	74.66	4,032,448.78
III	Fitimi (Humbja) para zhvlersimit	-1,140,424.32	88,373.01	-1,228,797.33	-1290.47	172,389.00
	GRANTET	939,804.68	898,946.46	40,858.22	104.55	899,591.94
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	939,804.68	898,946.46	40,858.22	104.55	899,591.94
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	45,505.74	71,595.96	-26,090.22	63.56	72,699.84
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	985,310.42	970,542.42	14,768.00	101.52	972,291.78
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	-1,185,930.06	16,777.05	-1,202,707.11	-7068.76	99,689.16


VËREJTJE

Kjo humbje ka ardhur si rrjedhojë e mosmbulimit të shpenzimeve në Transportin e Udhëtarëve nga Ministria e Infrastrukturës ashtu siq parashihet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit janar – dhjetor 2016



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive janar – dhjetor 2016



V. 2. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.12.2016)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2016
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	19,093.08
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.00
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	5,201.88
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	15,322.64
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	4,073.39
7	BPB	7,243.41
	Totali	**50,934.40**

V. 3. BILANCI I GJENDJES

BILANCI I GJENDJES		
NP HK – TRAINKOS SH.A	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/16**	**GJENDJA PERFU. 31/12/16**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**5,814,439.90**	**5,908,644.37**
Mjetet Qarkulluese	**4,763,721.56**	**3,505,533.00**
Stoqet	581,762.42	424,433.42
Paraja	1,826,035.90	51,046.91
Llogarite e arketueshme	1,354,097.70	1,807,575.87
Kerkesa tjera te arketushme		
Parapagimet	1,001,825.54	1,222,476.80
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**10,578,162.20**	**9,414,177.37**
Detyrimet afatshkurta	**507,945.95**	**1,085,201.18**
Llogarite e pagueshme	475,425.35	1,056,070.51
Te pagueshme tjera - detyrime		
Detyrime tatimore	32,520.60	29,131.21
Llogarite Inter Company		
Detyrimet afatgjata	**4,142,027.46**	**4,908,768.98**
Kapitali	**5,888,257.69**	**4,558,481.61**
Fitimi/Humbja e bartur		47,655.66
Fitim/ Humbja e vitit	-39,931.10	-1,185,930.06
Total detyrimet dhe kaptali	**10,578,162.20**	**9,414,177.37**

VI. PROJEKTET KAPITALE TË HK-TRAINKOS SH. A.

Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontratës	Koment
Furnizimi me material administrativ	22.02.2016	€ 6,000.00	€ 5,154.25	Përfunduar
Furnizimi me vaj lokomol	19.02.2016	€ 7,000.00	€ 6,282.00	Përfunduar
Furnizimi me lokomotivë me riparim gjeneral për transport të kombinuar	16.09.2016	1,100,000.00	€ 832,947.00	Përfunduar
Riparimi i motorit të lokomotivës 004	06.10.2015	€ 250,000.00	€ 133,423.00	Zbatim
Furnizimi me pajisje digjitale për testimin e sistemit të frenimit te mjeteve lëvizëse	19.05.2016	€ 8,700.00	€ 5,616.30	Përfunduar
Shërbimet e transportit për motorin e lokomotivës 009	29.01.2016	€ 2,000.00	€ 1,900.00	Përfunduar
Riparimi i gjeneratorit kryesor për lokomotivën 004	07.07.2016	€ 9,200.00	€ 9,150.00	Zbatim
Furnizimi me inventar - Karrige Pune	22.07.2016	€ 1,200.00	€ 1,185.00	Përfunduar
Furnizimi me kabllo	21.07.2016	€ 1,725.00	€ 1,097.26	Përfunduar
Furnizimi me filtra për mjete lëvizëse	30.08.2016	€ 4,200.00	€ 3,807.27	Përfunduar
Furnizimi me pjese për automjete	08.07.2016	€ 2,900.00	€ 2,741.82	Përfunduar
Furnizimi me papuçe frenuese	30.08.2016	€ 8,540.00	€ 8,537.50	Përfunduar
Sigurimi i Automjeteve të Trainkos Sh.a	23.05.2016	€ 1,900.00	€ 1,818.83	Përfunduar
Furnizimi me material higjienik	03.05.2016	€ 6,000.00	€ 3,775.06	Përfunduar
Furnizimi me tonera	16.05.2016	€ 6,000.00	€ 3,890.94	Përfunduar
Furnizimi me pajisje të IT-së	22.03.2016	€ 2,300.00	€ 2,159.40	Përfunduar
Shërbimet e konsulencës për matjen e kënaqshmerisë së klientëve	27.04.2016	€ 5,000.00	€ 1,999.00	Përfunduar
Furnizimi me pajisje të IT-së	29.07.2016	€ 9,000.00	€ 6,521.50	Përfunduar
Sigurimi ifizik i objekteve	20.09.2016	€ 45,000.00	€ 0.00	Zbatim
Bartja e thëngjillit nga stacioni në Ngrohtore	30.11.2015	€ 700.00	€ 462.50	Përfunduar
Punimi i dollapit	18.03.2016	€ 150.00	€ 150.00	Përfunduar
Furnizimi me goma	07.06.2016	€ 360.00	€ 328.00	Përfunduar
Furnizimi me alternator	13.06.2016	€ 450.00	€ 450.00	Përfunduar
Rregullimi i fotokopjes	18.06.2016	€ 250.00	€ 224.00	Përfunduar
Servisimi i derës hyrëse të MML kanali nr. 2	28.06.2016	€ 350.00	€ 300.00	Përfunduar
Riparimi i derës hyrëse të MML kanali nr. 3	28.06.2016	€ 990.00	€ 950.00	Përfunduar
Furnizimi me klimë	05.08.2016	€ 350.00	€ 300.00	Përfunduar
Rregullimi i makinës për larjen e automjeteve	29.08.2016	€ 260.00	€ 200.00	Përfunduar
Rregullimi i automjetit	22.09.2016	€ 250.00	€ 200.00	Përfunduar
Furnizimi me vajra dhe lubrifikante	27.06.2016	€ 100,000.00	€ 18,547.00	Zbatim + 9+ 9+ 9+
Furnizimi me cilindër	11.02.2016	€ 300.00	€ 150.00	Përfunduar
Punimi i bazamentit dhe gypave lidhës	19.02.2016	€ 500.00	€ 320.00	Përfunduar
Libërlidhja Qeverisja Korporative	26.03.2016	€ 350.00	€ 312.00	Përfunduar
Furnizim me blloka Depoje	05.05.2016	€ 400.00	€ 377.50	Përfunduar
Furnizimi me aparat	28.03.2016	€ 450.00	€ 400.00	Përfunduar
Furnizimi me bateri për gjenerator	24.01.2016	€ 400.00	€ 362.52	Përfunduar

Furnizim me bateri për trenin motorik	24.01.2016	€ 800.00	€ 784.00	Përfunduar
Rregullimi i gypit në ngrohtore	16.01.2016	€ 200.00	€ 150.00	Përfunduar
Rregullimi i statorit	16.01.2016	€ 990.00	€ 980.00	Përfunduar
Rregullimi i automjetit ngjyrosja	09.03.2016	€ 350.00	€ 350.00	Përfunduar
Sigurimi i palëve të treta	17.01.2017	€ 3,000.00	€ 1,888.00	Zbatim
Sigurimi i palëve të treta	16.12.2016	€ 500.00	€ 424.00	Përfunduar
Furnizim me agjenda kimika dhe kalendar	13.12.2016	€ 985.00	€ 975.00	Përfunduar
Furnizim me kabllo	12.12.2016	€ 300.00	€ 209.00	Përfunduar
Furnizimi me arka fiskale	04.10.2016	€ 990.00	€ 975.12	Përfunduar
Furnizimi me material për depo	06.10.2016	€ 150.00	€ 124.89	Përfunduar
Furnizimi me derë për depo	05.10.2016	€ 120.00	€ 114.90	Përfunduar
Furnizimi me bateri	15.11.2016	€ 700.00	€ 597.00	Përfunduar
Furnizimi me pucfall	06.10.2016	€ 350.00	€ 310.00	Përfunduar
furnizimi me gjenerator	08.10.2016	€ 900.00	€ 800.00	Përfunduar
Furnizimi me goma	27.10.2016	€ 999.00	€ 990.00	Përfunduar
Riparimi i kardanave	01.11.2016	€ 250.00	€ 170.00	Përfunduar
Furnizimi me thika për torno	02.10.2016	€ 600.00	€ 520.00	Përfunduar
rregullimi i xhamave	14.11.2016	€ 300.00	€ 270.00	Përfunduar
Furnizimime radiator	12.11.2016	€ 700.00	€ 682.40	Përfunduar
Furnizimi me ventila	16.11.2016	€ 530.00	€ 484.50	Përfunduar
Rregullimi i xhamave në terno	15.11.2016	€ 320.00	€ 300.00	Përfunduar
Furnizimi me bateri për trena motorikë	22.01.2016	€ 800.00	€ 784.00	Përfunduar
Furnizimi me valvula	17.11.2016	€ 540.00	€ 518.00	Përfunduar
Riparim i lokomotivave – rifabrikimi furnizim me vagonë të përdorur të udhëtarëve me riparim të mesëm	22.12.2016	€ 1,300,000	€ 1,181,666.00	Në procedurë
		2,898,549.00	€ 2,251,106.46	

Furnizimi me lokomotivë dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar (mallra - udhëtarë) - është projekt i financuar nga Buxheti i Kosovës. Projekti është në fazën e pranimit përfundimtar dhe të përmbylljes së tërë projektit. Për vitin 2016 për këtë projekt janë paguar 832,947.00 €. Projekti ka përfunduar dhe në periudhë të garancionit.

Riparimi gjeneral me konvertim i dizel motorit dhe kompresorit të lokomotivës 004 - është po ashtu projekt i financuar me Buxhetin e Kosovës. Projekti është në zbatim dhe për shkak të disa komplikimeve një pjesë e projektit është bartur në vitin 2016.

Sigurimi fizik i objekteve të HK-Trainkos Sh. A. - është kontraktuar dhe është në zbatim. Kontrata, është kontratë kornizë në kohëzgjatje prej një viti.

Furnizimi me vajra dhe lubrifikante – është projekt i kontraktuar si kontratë kornize dhe është në zbatim e sipër.

Projektet me vlera minimale – Të gjitha projektet me vlera minimale janë projekte të cilat janë realizuar.

Vërejtje: Për shkak të gjendjes së kompanisë shumë nga projektet e realizuara nuk janë paguar dhe si rezultat furnizimet e reja janë duke u realizuar me mjaft vështirësi.

VII. PRERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Perspektiva për vitin 2017 është e lidhur ngushtë me objektivat ekonomike të diskutuara dhe precizuara në Planin e Biznesit për vitin e ardhshëm të paraqitura më poshtë.

- Ngritja e vazhdueshme profesionale e kapaciteteve të resurseve njerëzore;
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit të qëndrueshëm me partnerët/operatorët rajonal dhe mundësisht edhe të atyre nga vendet e BE-së në transportin hekurudhor;
- Rritja e cilësisë dhe kualitetit të shërbimit në transportin hekurudhor, për një zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrjes;
- Gjetja e modeleve për financimin e pasurimit/rritjes së parkut të mjetëve lëvizëse sipas strategjisë zhvillimore të kompanisë krahas reformave në sektorin hekurudhorë;
- Realizimi i të hyrave në bazë të parametrave të projektuar në Planin e Biznesit 2017 për transportin hekurudhorë;
- Angazhimi i vazhdueshëm në shfrytëzimin e të gjitha mundësive për përvetësimin e transportit të mundshëm të mallrave brenda dhe jashtë vendit;
- Të kemi një OShP të aprovuar e që ndikon në mbulimin e humbjeve për transportin e mallrave dhe krijon mundësitë e angazhimit maksimal në ofrimin e shërbimit për transportin e udhëtarëve me saktësi, komoditet dhe çmim konkurrues;
- Aktiviteti në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse në vitin 2017 do të karakterizohet me angazhimin e përhershëm në avancimin e proceseve në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm për certifikimin e punëtorive sipas kritereve të parapara me ERA;
- Krijimi i kushteve më të mira për punë që mundëson ngritjen e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Zbatimi i Rregullores së re për transportin e mallrave dhe hulumtimi i tregut në përvetësimin e tregut që i përket transporti hekurudhorë me një çmim konkurrues;

VII. 1. RREZIQET E SË ARDHMES SË KORPORATËS


TRAINKOS Sh.A. që nga procesi i ndarjes dhe fillimi i aktivitetit si Operator Hekurudhor është ndeshur me disa rreziqe që e përcjellin kompaninë në vazhdimësi, e që janë bërë kërcenim edhe për të ardhmen e saj. Angazhimi ynë në këtë drejtim do të fokusohet në minimizimin e këtyre efekteve të precizuara më poshtë:

- Mosekzistimi i një Plani të Biznesit afatmesëm të kompanisë;
- Numri i vogël i mjeteve lëvizëse dhe vjetërsia e tyre të flotës ekzistuese të mjeteve lëvizëse;
- Mosmbulimi i shpenzimeve të Transportit të Udhëtarëve përmes Marrëveshjes së Obligimeve Publike (OShP) sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës;
- Buxheti i vogël për investime kapitale dhe nevoja e gjetjes së burimeve financiare nëse e kemi parasysh koston e lartë të investimeve në mjetet lëvizëse;
- Kontestet gjyqësore të trashëguara nga Hekurudhat e Kosovës;
- Nevoja e avancimit dhe zhvillimit të proceseve në transportin intermodal dhe përcjellja e proceseve në zbatimin e Strategjisë së Transporti Multi-Modal;
- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;
- Futja e operatorëve të rinj në treg;

VIII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. vitin 2016 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2015. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2016, ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos Sh.A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos -Sh.A. më 1 Janar 2016 dhe më 31 Dhjetor 2016					
Totali i të punësuarve	01.01.2016		31.12.2016		
	231		236		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Datat	01.01.2016	31.12.2016	01.01.2016	31.12.2016	
Mosha mesatare e punëtorëve	46.42	46.62	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	231	236	%	%	Frmat e kontratave
Me kontratë të paafatizuar	69	107	29.87 %	45.34 %	
Me kontratë të afatizuar	162	129	70.13 %	54.66%	
Meshkuj	206	212	89.18 %	89.83 %	Gjina
Femra	25	24	10.82 %	10.17 %	
Serb	2	2	0.87 %	0.85 %	Naionaliteti.
Shqiptarë	229	234	99.13 %	99.15 %	
Me shkollim fillor	17	17	7.36 %	7.20 %	Shkllimi
Shkollim Të mesëm	137	129	59.30 %	54.66 %	
Kualifikim profesional	21	23	9.10 %	9.75 %	
Me shkollim të lartë	4	4	1.73 %	1.70 %	
Me shkollim superior	52	63	22.51 %	26.69 %	
Departamenti i Operimeve	142	143	61.47 %	60.59 %	Prshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Administratës	44	43	19.05 %	18.22 %	
Departamenti i Financave	8	9	3.46 %	3.81 %	
Departamenti i Zhvillimit	6	6	2.60 %	2.54 %	
Departamenti i Prokurimit	3	4	1.30 %	1.69%	Kabineti i KE-së dhe Zyret në kuadër të KE-së
Kabineti i KE-së	9	8	3.90 %	3.39 %	
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	15	19	6.49 %	8.05 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	4	4	1.73 %	1.69 %	

Sqarim: *Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 kemi pasur 11 punësime, 2 pensionime, 1 ndërprerje të një anshme të marrëdhënies së punës, 2 punëtorëve ju ka ndërpre marrëdhënia e punës dhe 1 punëtorë të vdekur. Gjatë vitit 2016 kemi pasur 10 punëtorë me kontratë për punë specifike, të cilët nuk janë përfshirë në tabelën më lart. Po ashtu në këtë tabelë nuk janë përfshirë as anëtarët e Bordit të Drejtorëve.*

VIII. 1. KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2016

Gjatë periudhës njëvjeçare Departamenti i Administratës/Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka mbajtur gjithsejtë 56 seanca gjyqësore. Kontestet Gjyqësore janë një ndër rreziqet kryesore të kompanisë, sidomos kontestet nga marrëdhënia e punës dhe kontestet për kompensim dëmi.

Këto procese janë të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës si rezultat edhe i mos përfilljes së procedurave dhe kontratave nga menaxhmenti i asaj kohe. Me qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të kompanisë, duke u bazuar në aktet normative të aplikueshme në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A. Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme. Në propozimin e nxjerrjes së provave përmes ekspertizave dhe super ekspertizave në rastet e mungesës së disa provave me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë – kontributit të pjesëmarrësve në komunikacionin hekurudhor dhe zgjidhjes së këtyre kontesteve në favor të kompanisë Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka ndërmarr të gjitha veprimet në sigurimin e të gjitha provave elementare për ta mbrojtur kompaninë nga paditësit që kanë ngritur padi kundër Hekurudhave e Kosovës Trainkos Sh. A. për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo materiale. Të gjitha këto aspekte janë trajtuar në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale nga zyrtarët ligjorë të Kompanisë.

Kategoritë e kontesteve për vitin 2016	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	7
Kontestet për kompensim të dëmit	11
Kontestet për pagim të borxhit	5

Gjatë vitit 2016 1 (një) kontest nga marrëdhënia e punës ka përfunduar sepse pala ka vdekur dhe 1 (një) kontest ka përfunduar me marrëveshje.

Gjatë vitit 2016 për 3 (tri) konteste të kompensimit të dëmit është tërhequr padia deri në plotësimin e kushteve ligjore për inicimin e padisë si dhe 2 (dy) konteste për kompensim dëmi kanë përfunduar me marrëveshje gjyqësore.

Po ashtu gjatë vitit 2016 ka përfunduar 1 (një) kontest për kompensim dëmi në disfavor të Kompanisë me procedurë të përmbarimit, mirëpo e njëjta është kthyer në rigjykim në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.153/2016 i datës 01.09.2016.

Gjatë vitit 2016 ka përfunduar 1 (një) kontest për pagim borxhi në favor të kompanisë me procedurë të përmbarimit si dhe për 1 (një) kontest është ndërprerë procedura me propozim të palës paditëse.

VIII. 2. KONTESTET GJYQËSORE TË PRITURA NË VITIN 2017

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. në vitin 2017, pritet të ballafaqohen me 58 (pesëdhjetë e tetë) konteste gjyqësore që nga procedura fillestare e deri te revizioni. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të kemi ftesë nga gjykatat gjatë vitit 2017:

Kategoritë e kontesteve për vitin 2017	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	17
Kontestet për kompensim të dëmit	28
Kontestet për pagim të borxhit	12
Kontestet administrative	1

Në bazë të kësaj gjendjeje, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që kontestet gjyqësore janë në numër shumë të madh si dhe me vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompania do të dëmtohet financiarisht. Kontestet janë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut dhe një pjesë e madhe edhe pas daljes së kompanisë nga administrimi i UNMIK.

Kontestet nga marrëdhënia e punës

Gjatë vitit 2017 nga kontestet e marrëdhënies së punës në procedurë gjyqësore do të jenë 17 (shtatëmbëdhjetë), prej të cilave në shkallë të parë për momentin gjenden 3 (tri) konteste, kurse në shkallën e dytë gjenden 13 (trembëdhjetë) konteste dhe 1 (një) në shkallën e tretë.

Kontestet për kompensim dëmi

Nga kontestet për kompensim të dëmit gjithsejtë në procedurë gjyqësore gjenden 28 (njëzetë e tetë) konteste.

Gjatë vitit 2017 nga kontestet e kompensimit të dëmit në procedurë gjyqësore në shkallë të parë për momentin kemi 14 (katërmbëdhjetë) konteste ndaj të cilave vazhdon procesi gjyqësor, kurse në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë gjenden në procedurë (shkalla e dytë) 12 (dymbëdhjetë) konteste dhe 2 (dy) konteste në shkallën e tretë.

Vlen për të theksuar se numri i kontesteve për kompensim dëmi po shtohet dhe kjo varësisht nga ndodhja e aksidenteve në komunikacionin hekurudhor.

Kontestet për pagim të borxhit

Nga kontestet për pagim borxhi gjatë vitit 2017 në procedurë gjyqësore kemi 12(dymbëdhjetë) konteste prej të cilave 11(njëmbëdhjetë) në procedurë në shkallën e parë, kurse 1(një) në procedurë të përmbarimit N.T.SH.'Ballkan Shped'.

Tani nuk mund të supozojmë për sa konteste Gjykata e Apelit të Kosovës do të vendos gjatë vitit 2017 (të gjitha kategoritë e kontesteve), dhe sa konteste do t'i kthej në rigjykim, por kemi theksuar vetëm numrin e kontesteve që gjenden në procedurë gjyqësore.

IV. 3. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR - DHJETOR 2016

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2016	474,938.06
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2016	2,772,913.19
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2016	2,317,068.21
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2016	19,093.08

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2016	276,296.95
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor2016	800,000.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2016	1,076,296.95
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2016	0.00

V. PËRFUNDIM

Përkundër angazhimeve të vazhdueshme në realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit 2016 Trainkos Sh.A. nuk ka arritur që të përmbush të gjitha këto objektiva. Trendi i vazhdueshëm nga vitet e mëparshme në mosplotësimin e parakushteve për shërbime të mirëfillta të transporti ka kulmuar në gjendjen dhe realizimin e vitit 2016. Ndërprerja e transportit për një pjesë të madhe të vitit nga klienti strategjik New Co Ferronikeli ka ndikuar në realizimin e të hyrave për të realizuar objektivat tona në transportin e mallrave. Në transportin e udhëtarëve mosrealizimi i objektivave është si rezultat i mosmbulimit të shpenzimeve nga ana e Qeverisë. Këto shpenzime nuk mbulohen që nga procesi i ndarjes së HK-së në vitin 2011 ashtu siç është parashikuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës. Pra, në transportin e udhëtarëve nuk janë mbuluar humbjet nga Qeveria për këtë shërbim, humbjet e funksionimit të trenave në linjat e aprovuara nga Ministria e Infrastrukturës.
TRAINKOS-i, nga këto rrethana ka qenë i detyruar në zbatimin e politikës së kursimit me pasoja që reflektojnë në minimizimin e shpenzimeve të përllogaritura paraprakisht për një ofrim të shërbimit më të mirë të mundshëm. Njëkohësisht janë grumbulluar borxhe nga afarizmi siç janë precizuar në raport e që kanë efekt në afarizmin e vitit 2017.

Angazhimi i përgjegjësve në kompani është i orientuar në krijimin e mundësive për të bërë një planifikim afatmesëm që është pjesë përbërëse e planifikimeve afatgjata të Qeveris së Kosovës për sektorin hekurudhor. Përgatitja e një Plani të Biznesit pesëvjeçar me pjesëmarrje aktive të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik do të mundësonte projektimin e domosdoshëm të politikave për ofrimin e transportit hekurudhor të udhëtarëve në linjat e aprovuara dhe në zbatimin e konceptit bazik për zhvillim ekonomik të Kosovës për transportimin e mallrave specifik dhe me pesha të rënda përmes hekurudhës.

Planifikimet strategjike për sektorin hekurudhor kanë lënë të padefinuar/anash problematikën e mirëmbajtjes së mjeteve lëvizëse hekurudhore për të cilën duhet të punohet me precizitet në proceset e hartimit të një Plani të Biznesit tre apo pesë vjeçar për TRAINKOS-in. Kjo nëse i kemi parasysh planifikimet e Qeverisë të precizuara në "Strategjia Sektoriale dhe Transporti Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar" për ofrimin e mundësisë së modernizmit të flotës së mjeteve lëvizëse sipas proceseve tjera reformuese në sektorin hekurudhorë. Sfidë tjetër në këtë proces është edhe angazhimi në ngritjen e nivelit profesional të stafit dhe kapaciteteve sipas standardeve të kërkuara.

Për kalimin e kësaj situate TRAINKOS-i me të gjitha nivelet ekzekutive është i përkushtuar maksimalisht për mbarëvajtjen e punëve në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve të cilat ofron.

Fushë Kosovë,
14.03.2016

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala